

VENDIM
Nr. 129, datë 11.9.2012

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA, PËR
MIRATIMIN E NJË MARRËVESHJEJE HIPOTEKORE NDËRMJET “CEZ SHPËRNDARJE”
SHA DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD) DHE
KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFC), NË KUADËR TË HUAS BANKARE
PREJ 100 MILIONË EUROSH TË MARRA NGA KOMPANIA “CEZ SHPËRNDARJE” SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7, 11 pika 1 germa “a”, “c” dhe “d” të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.9.2012, pasi shqyrtoi kërkesën për lënien peng të aseteve si kolateral nga shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a., pranë bankave IFC/EBRD, si dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për miratimin e një marrëveshje hipotekore ndërmjet “CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC), në kuadër të huas bankare prej 100 milionë eurosh të marra nga kompania “CEZ Shpërndarje” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani